UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 5, datë 6.9.2016

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PROCESIN E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe pikës 11, të nenit 12, të ligjit nr. 91, datë 28.2.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor",

UDHËZOJMË:

1. Miratimin e tarifës së shërbimit për shqyrtimin e kërkesës për vlerësimin strategjik mjedisor, në vlerën prej 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë.

2. Tarifa derdhet nga zhvilluesi në llogarinë bankare të Ministrisë së Mjedisit dhe është e pakthyeshme. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e përcaktuara në këtë udhëzim derdhen në Buxhetin e Shtetit në masën 100%.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Ministria e Mjedisit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj